Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec/Opština Orahovac/Municipal of Rahovec

DREJTORIA PËR ARSIM/ODELJENJE ZA OBRAZOVANJE
DEPARTMENT OF EDUCATION

Me dt. 19.04.2013, Rahovec

Në bazë të nenit 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 6 të Statutit të Komunës, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ të MASH-it nr. 03/2009 të datës 09.02.2009, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës **Drejtor** në :

1. SHFMU " Isa Boletini në Rahovec,
2. SHFMU " Sulejman Vokshi në Palluzhë,
3. SHFMU " Sapniqi" Sapniq,
4. SHMFU " Tre Dëshmorët " në Vrajakë - Bratatin,
5. SHML " Ukshin Hoti " në Krushë të Madhe
6. Çerdhja e fëmijëve "Tulipanët " në Rahovec.

Kushtet për konkurrim: Kandidatët e interesuar për konkurrim në vendet e punës për drejtor shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
2. Të kenë të përfunduar njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara nga MASHT-i,
3. Të kenë së paku tre vite përvojë pune në arsim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

a) Certifikata e lindjes,
b) Diploma e fakultetit të kryer,
c) CV sipas modelit të MASHT-it ,
d) Rekomandim nga një person apo institucion publik kredibil,
e) Programin zhvillimor të shkollës ku konkurron, më së shumti 5 faqe tekst,
f) Dëshminë për përvojën e punës,
g) Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara,
h) Certifikatën shëndetësore.

Kushtet e punës: Drejtori i Shkollës duhet të planifikojë dhe të organizojë punën e përgjithshme në shkollë. Në bashkëpunim me MASHT-in dhe DKA-në të merr vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e mirëfilltë të mësimdhënies dhe arsimimit në shkollë.

Kohëzgjatja: Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe zgjat 4 vite, duke përfshirë edhe periudhën tremujore provuese.

Aplikacionet merren në zyrën e DKA-së dhe dokumentet e kompletuara dorëzohen po aty.

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes (publikimit).

Drejtoresha
Besa Hoxha Beqiri